



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2020

V E N D I M

Nr. 44, Datë 12/05/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 139, datë 31.10.2019, e znj. L.Gj., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”¹, nga ana e z. E.C., Kryetar i Këshillit Bashkiak Berat dhe z. E.D., Kryetar i Bashkisë Berat.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se znj. L.Gj. ka punuar në pozicionin e Sekretares së Këshillit Bashkiak, në Bashkinë Berat, që prej datës 04.08.2015. Ankuesja pretendon se pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019, me ardhjen në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë Berat, i cili është përfaqësues i forcës politike “Partia Socialiste”, si dhe krijimit të Këshillit të ri Bashkiak, ajo u ekspozua ndaj diskriminimit për shkak të bindjes politike.

Nëpërmjet Vendimit nr. 8, datë 05.08.2019, të Këshillit Bashkiak Berat, znj. L.Gj. është shkarkuar nga pozicioni i Sekretarit të Këshillit Bashkiak dhe në vijim nëpërmjet Urdhërit nr. 5819, datë 09.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare, që ankuesja ka patur me këtë institucion. Të dy aktet e mësipëme nuk kanë motivacion mbi shkaqet e shkarkimit të saj nga detyra.

Për sa më sipër, ankuesja pretendon se janë shkelur parashikimet e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të neneve 16 dhe 18, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Berat”, ku përcaktohet mënyra dhe procedurat, që duhen ndjekur për emërimin dhe shkarkimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak, në Bashkinë e Beratit.

¹ Referuar kartës së anëtarësisë nr. 4627, datë 12.04.2016, të lëshuar nga subjekti politik “Lëvizja Socialiste për Integritet”, rezulton se ankuesja është anëtare e kësaj force politike.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në këtë kontekst, Znj. L.Gj. pretendon se diskriminohet për shkak të bindjes politike, nga ana e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Berat dhe Kryetarit të Bashkisë Berat.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

A. Pas analizimit të ankesës nr. 139, datë 31.10.2019, së Znj. L.Gj. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1531/2, datë 06.11.2019, Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë Berat dhe për dëjoni ankueses, ku kërkohej informacioni, si më poshtë vijon:

- Kopje të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Berat për emërimin dhe shkarkimin e ankueses, në pozicionin e Sekretares së Këshillit Bashkiak Berat;
- Kopje të akteve administrative të lëshuara nga Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet së cilëve është kryer emërimi dhe shkarkimi i ankueses në pozicionin e mësipërm të punës;
- Praktika e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me ankuesen;
- Kopje e librezës së punës së ankueses;
- Vlerësimet në punë për Znj. L.Gj., përgjatë viteve që ka punuar në pozicionin e Sekretarit pranë Këshillit Bashkiak Berat;
- Informacion nëse ndaj ankueses janë dhënë masa disiplinore, që nga viti 2015 -2019;
- Kopje e Rregullores “*Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Berat*”.
- Informacion nëse Bashkia Berat ndodhet në procese gjyqësore me ankuesen. Nëse po, të informohet KMD, mbi objektin/et e padisë/ve, ose me vendimet gjyqësore përkatëse, në rast se çështjet kanë përfunduar së gjykuari.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 1531/2, datë 06.11.2019, të KMD-së, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë dërgoi shkresën nr. 5691/2, datë 15.11.2019, nëpërmjet së cilës informon se bashkëlidhur dërgohen aktet e mëposhtëme:

- Vendimi nr. 16, datë 04.08.2015, e Këshillit Bashkiak Berat, “*Mbi zgjedhjen e sekretarit të Këshillit të Bashkisë*”;

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

- Kopja e librezës së punës së znj. Ledina Gjorozeni;
- Kopje e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Berat”;
- Kopje e Urdhërit nr. 589, date 09.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë, “Për përfundimin e marrëdhënieve financiare të Sekretarit të Këshillit të Bashkisë znj. Ledina Gjorozeni”;
- Vendimi nr. 8, datë 05.08.2019, i Këshillit Bashkiak, “Për shkarkimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak znj. Ledina Gjorozeni”;

Në shkresën nr.5691/2, datë 15.11.2019, e Bashkisë Berat sqarohet gjithashtu se ndaj ankueses nuk është marrë ndonjë masë disiplinore përgjatë periudhës kohore 2015 – 2019, si dhe e informon KMD, se aktualisht ky institucion ndodhet në proces gjyqësor me ankuesen mbi zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Për sa më sipër, ankuesja ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë kërkesë padinë nr. 1455, datë 20.09.2019, me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 8, datë 05.08.2019 “Për shkarkimin nga detyra të Sekretares së Këshillit Bashkiak””. Me Vendimin nr. 979, datë 30.09.2019, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është deklaruar moskompetenca lëndore për gjykimin e çështjes civile nr. 1455 Regj., datë 20.09.2019, me palë paditëse L.Gj., si dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

2. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 31.01.2020, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore morën pjesë ankuesja L.Gj. dhe përfaqësuesja e saj ligjore, si dhe përfaqësuesja e Bashkisë Berat, e cila depozitoi pranë KMD-se, aktin nr.--Prot., datë 24.01.2020, të lëshuar nga Kryetari i Bashkisë Berat.

Ankuesja dhe përfaqësuesja e saj ligjore shprehën edhe një herë pretendimet e tyre në seancë duke vënë theksin në largimin e padrejtë nga detyra e Sekretares së Këshillit Bashkiak, të znj. L.Gj., menjëherë pas ardhjes në detyrë të Kryetarit të ri të Bashkisë dhe krijimit të Këshillit të ri Bashkiak. Ankuesja theksoi faktin se ajo është paraqitur vetëm 1 ditë në punë dhe nuk është njoftuar fare për mbledhjen e Këshillit të ri Bashkiak, edhe pse ka kërkuar të marrë pjesë në këtë mbledhje. Përfaqësuesja ligjore e ankueses u shpreh se pozicioni i ankueses është konsideruar si post politik, sikurse posti i Kryetarit dhe Nënkryetarit të Bashkisë, ndërkohë që Sekretarja e Këshillit Bashkiak kryen vetëm funksione dhe detyra administrative. Përfaqësuesja e Bashkisë Berat u shpreh se pozicioni i Sekretares së Këshillit Bashkiak nuk gëzon statusin e nëpunësit civil dhe se është Këshilli Bashkiak që e emëron personin që do të punojë në këtë pozicion, sikurse parashikohet edhe në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Pikërisht ky organ kolegjal është i ngarkuar ligjërisht për emërimin dhe shkarkimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak, që në mbledhjen e dytë të tij. Përfaqësuesja e Bashkisë Berat theksoi faktin se kjo është një e drejtë e këtij Këshilli, i cili në mbledhjen e dytë të tij, ka shkarkuar znj. L.Gj. mbi bazën e propozimit të ardhur nga anëtarë të këtij këshilli. Kryetari i Bashkisë nxjerr aktin për lidhjen e marrëdhënieve financiare, mbi bazën e vendimit përkatës të Këshillit Bashkiak. E pyetur nëse Këshilli Bashkiak kishte dijeni mbi bindjen politike të ankuese, përfaqësuesja e Bashkisë Berat, u shpreh se nuk kishte dijeni mbi këtë fakt. E pyetur sërish se cila ishte natyra e detyrave që kryente Sekretari i Këshillit Bashkiak, përfaqësuesja e Bashkisë Berat sqaroi se detyrat e këtij pozicioni pune kishin natyrë administrative. Në seancë, përfaqësuesit e

KMD-së kërkuan informacion mbi punonjësen që e kishte zëvendësuar znj. L.Gj.. Përfaqësuesja e Bashkisë Berat u shpreh se Këshilli Bashkiak ka emëruar në këtë pozicion pune znj. B.A. Pala ankuese u shpreh se Sekretarja aktuale e Këshillit Bashkiak është anëtare e Partisë Socialiste të Shqipërisë. Në seancë dëgjimore, ankuesja ngriti pretendimin për diskriminim për shkak të përkatësisë në komunitetin egjiptian. Ajo u shpreh se një shkak i mundshëm diskriminimi është edhe se ajo i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Beratit.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesja dërgoi shkresën nr. 325, datë 24.02.2020, nëpërmjet së cilës përcolli pranë KMD-së, vërtetimin nr. 010/20, datë 11.02.2020, të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i shoqatës Roma Versitas Albania, nëpërmjet së cilit vërtetohet se ankuesja L.Gj. i përket komunitetit egjiptian. Përveç sa më sipër, ankuesja ka përcjellë për dijëni të KMD-së edhe disa foto e fakte, që lidhen me aktivitetin politik të Sekretares aktuale të Këshillit Bashkiak Berat me subjektin politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuseses.

Në ankesën nr. 139, datë 31-10.2019, e znj. L.Gj., pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”⁴ dhe “*racës*”⁵ nga ana e z. E.C., Kryetar i Këshillit Bashkiak Berat dhe z. E.D., Kryetar i Bashkisë Berat.

Znj. L.Gj. është emëruar në pozicionin e Sekretares së Këshillit Bashkiak nëpërmjet Vendimit nr. 16, datë 04.08.2015, të Kryetarit të Këshillit Bashkiak Berat. Ndërmjet palëve nuk është lidhur një kontratë individuale pune, por në kushtet kur Ligji nr. 139/2019 “Për vetëqeverisjen vendore” nuk shprehet për detaje rregulluese mbi marrëdhëniet e punës për këtë pozicion pune, do të konsiderohet e mirëqenë që marrëdhëniet e punës së znj. L.Gj. rregullohen nga dispozitat përkatëse të Kodit të Punës.

Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019 dhe me ardhjen në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë Berat z. E.D., si dhe krijimin e Këshillit të ri Bashkiak me në krye z. E.C., znj. L.Gj. lirohet menjëherë nga detyra. Nëpërmjet Vendimit nr. 8, datë 05.08.2019, të Këshillit Bashkiak “Për shkarkimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak znj. L.Gj.” ankuesja shkarkohet nga detyra. Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 589, datë 09.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, urdhërohet përfundimi i marrëdhënieve financiare të znj. L.Gj., e cila në bazë të këtij urdhëri ka kryer edhe dorëzimin e detyrës së saj.

⁴ Referuar kartës së anëtarësisë nr. 4627, datë 12.04.2016, të lëshuar nga subjekti politik “*Lëvizja Socialiste për Integrit*”, rezulton se ankuesja është anëtare e kësaj force politike.

⁵ Referuar Vërtetimit nr. 010/20, datë 11.02.2020, të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Roma Versitas Albania.

Për sa më sipër, mbështetur në pikën 1, të nenit 57, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikohet: *“1. Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli bashkiak, në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.”*

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se Sekretari i Këshillit Bashkiak emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Bashkiak, i cili është një organ kolegjal. Emërimi apo shkarkimi i sekretarit të Këshillit Bashkiak mund të kryhet në bazë të propozimit të Kryetarit të Këshillit, me shumicën e votave të anëtarëve të këshillit. Kjo dispozitë njihet edhe të drejtën e 1/3 e anëtarëve të Këshillit për të propozuar shkarkimin e sekretarit. Në rastin e shkarkimi të znj. L. Gj. është ndjekur opsioni i parë i parashikuar nga dispozita e sipërpërmendur

Referuar aktit “Protokoll” të mbajtur në datën 05.08.2019, gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak, rezulton se në pikën 2 të rendit të ditës, është përcaktuar shqyrtimi i projektvendimit për shkarkimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak dhe emërimi i Sekretarit të ri të këtij Këshilli. Referuar faqes 2, të këtij Protokollit citohet: *“E.C. (Kryetari i Këshillit Bashkiak Berat - Vazhdojmë me pikën II. Propozoj këtu të hapur⁶ për shkarkimin e sekretares se Këshillit Bashkiak. 23 këshilltarë prezentë në votim. 23 vota miratohet shkarkimi nga detyra e Sekretares së Këshillit Bashkiak L.Gj.”*

Në faqen 3 të këtij Protokollit citohet gjithashtu thënia e znj. D. Gj.: *“Në emër të grupit të këshilltarëve të PS propozojmë që B. A. të jetë Sekretare e Këshillit Bashkiak”*. Në vijim të mbledhjes, është miratuar propozimi që znj. B.A. të emërohet Sekretare e Këshillit Bashkiak Berat.

Nëse do t'i referohemi përmbajtjes së Vendimit nr. 8, datë 05.08.2019 *“Për shkarkimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak znj. L.Gj.”* rezulton se në të nuk është shënuar asnjë motivacion mbi shkarkimin e ankuses. Në vendim citohet: *“1. Të shkarkojë znj. L.Gj. nga pozicioni i sekretarit të Këshillit Bashkiak. 2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Marrëdhëniet me Publikun dhe Juridike, Drejtoria e Financës.”*

Në vijim të Vendimit të sipërpërmendur, marrëdhëniet financiare të znj. L.Gj. ndërpritën nëpërmjet Urdhërit nr. 8, datë 05.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, *“Për shkarkimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak znj. L.Gj.”*. Në këtë urdhër citohet: *“1. Përfundimin e marrëdhëniet financiare të znj. L.Gj. nga pozicioni i punës Sekretar i Këshillit të Bashkisë Berat, pasi është shkarkuar sipas Vendimit nr. 8, datë 05.08.2019, të Këshillit të Bashkisë”*

Për sa më sipër, Komisioneri konstatoi se në aktet e miratuara të procedurës së shkarkimit të znj. L.Gj. nuk ekzistonte asnjë lloj motivacioni apo shkaku të arsyeshëm, për lirimin e saj nga detyra. Nga informacioni i administruar rezulton se ndaj Znj. L.Gj. nuk është marrë asnjëherë asnjë masë disiplinore gjatë periudhës kohore që ka punuar në këtë pozicion pune.

Pozicioni i punës së saj ka detyra të natyrës administrative, që përcaktohen shprehimisht në pikën 2, të nenit 57, të ligjit të sipërpërmendur, ku parashikohet: *“2. Sekretari i këshillit bashkiak*

⁶ Referuar shprehimisht Protokollit të datës 05.08.2019;

është përgjegjës për: a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit; b) ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve, sipas rendit të ditës; c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit; ç) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve e të akteve të nxjerra nga këshilli bashkiak; d) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë; dh) mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit. 3. Sekretari i këshillit bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.”

Për sa më sipër Komisioneri konstaton se pavarësisht detyrave me karakter administrativ, që Sekretari i Këshillit Bashkiak kryen, ai është konsideruar si post politik dhe punonjësi i emëruar është shkarkuar menjëherë në mbledhjen e dytë të Këshillit të ri, Bashkiak.

Në arsyetimin e tij lidhur me këtë çështje, Komisioneri i referohet Vendimit nr. 00-2014-854 (51), datë 28.01.2014, të Gjykatës së Lartë, lidhur me një rast analog me atë të znj. L.Gj.. Në këtë vendim citohet: “...Kolegji Administrativ vëren:

Së pari, sekretari i këshillit të njësisë vendore nuk është organ i pushtetit vendor, por është funksion publik, një detyrë që ushtrohet nga personi i emëruar (si i punësuar) për përmbushjen e këtij shërbimi publik.

Së dyti, funksioni i sekretarit të këshillit të njësisë vendore nuk është funksion politik.

Së treti, legjislacioni për pushtetin vendor nuk shprehet për “zgjedhje”, por për “emërim e shkarkim” nga detyra të sekretarit të këshillit të njësisë vendore.

Së katërti, legjislacioni për pushtetin vendor, ndryshe nga organet e pushtetit vendor, ndryshe nga të zgjedhurit (kryetari i njësisë, anëtarët e këshillave) në këto organe, nuk parashikon mandate apo ndonjë afat për kohëzgjatjen e ushtrimit të detyrës së sekretarit të këshillit të njësisë vendore.

Së pesti, funksioni dhe detyra e sekretarit të këshillit ushtrohen për një afat të pacaktuar, përderisa vetë ligji nuk përcakton një afat të tillë.

Së gjashti, lidhur me sekretarin e këshillit të njësisë vendore, legjislacioni i posaçëm për pushtetin vendor nuk përmban ndonjë parashikim lidhur me statusin juridik të tyre, ata nuk janë nëpunës civilë, por njëkohësisht nuk janë as funksionarë politikë dhe as organe të zgjedhura.....”

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në parashikimet e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Komisioneri gjykon se, pozicioni i Sekretari i Këshillit të Bashkiak nuk është organ i pushtetit vendor, por është një funksion publik, një detyrë që ushtrohet nga personi i emëruar (si i punësuar) për përmbushjen e këtij shërbimi publik. Referuar vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Lartë, funksioni i sekretarit të këshillit të njësisë vendore nuk është funksion politik. Neni 57, pika 1, i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nuk shprehet për “zgjedhje” por për “emërim e shkarkim” nga detyra të Sekretarit të Këshillit Bashkiak. Ligji i mësipërm ndryshe nga organet e pushtetit vendor dhe në ndryshim nga të zgjedhurit në këto organe, nuk parashikon mandate apo ndonjë afat për kohëzgjatjen e ushtrimit të detyrës së Sekretarit të

Këshillit Bashkiak. Funkzioni dhe detyra e Sekretarit të Këshillit Bashkiak ushtrohen për një afat të pacaktuar, përderisa vetë ligji nuk përcakton një afat të tillë.

Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nuk përmban ndonjë parashikim lidhur me statusin juridik të tyre. Sekretarët e këshillave bashkiakë nuk janë nëpunës civilë, por njëkohësisht nuk janë as funksionarë politikë dhe as organe të zgjedhura. Ky legjislacion nuk parashikon asnjë modalitet të veçantë, lidhur me procedurat dhe afatet që duhen respektuar përpara se Sekretarit të Këshillit Bashkiak t’i ndërpritet ushtrimi i detyrës, pra marrëdhënia e punës.

Në këtë kuptim, Komisioneri gjykon se marrëdhëniet e punës së Sekretarit të Këshillit Bashkiak rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës. Pavarësisht se ndodhemi në mungesë *de jure* të një kontrate individuale pune, znj. L.Gj. ka punuar prej vitit 2015 në pozicionin e punës Sekretar i Këshillit Bashkiak Berat, fakt i cili mbetet i pamohueshëm. Në reference dhe interpretim të nenit 140 të Kodit të Punës, kontrata e punës, në rastin konkret *de facto*, për sa kohë që nuk ka qenë e përcaktuar për një kohë të caktuar dhe për sa kohë që ligji specifik nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nuk përcakton shprehimisht se me përfundimin e një mandati 4 vjeçar, Sekretari i Këshillit Bashkiak do të pushojë funksionet e tij, atëherë prezumohet se kjo Kontratë është lidhur për një afat të pacaktuar. Në rastin e znj. L.Gj., kjo kontratë është zgjidhur në mënyrë të menjëherëshme.

Në referencë të nenit 153 të Kodit të Punës, vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit. Në çdo rast është Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës.

Por pavarësisht sa më sipër, KMD gjykon se si në Vendimin nr. 8, datë 05.08.2019, të “Për shkarkimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak znj. L.Gj.”, ashtu edhe në Urdhërin nr. 589, datë 09.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, nuk është shënuar asnjë motivacion apo shkak i justifikuar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesen. Njëkohësisht, sipas shkresës zyrtare të dërguar nga Bashkia Berat rezulton se ankuesja nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

Në lidhje me qëndrimin e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Berat, Komisioneri çmon se përgjegjësia e tij qendron në propozimin që i ka bërë Këshillit Bashkiak për shkarkimin e ankueses, ndërkohë që akti administrativ, i cili ka kryer veprimin e shkarkimit nga detyra të znj. L.Gj., i përket organit kolegjal dhe jo drejtuesit të tij. Në kushtet kur, nuk ekziston asnjë motivacion, apo arsye e justifikuar për shkarkimin e menjëherëshëm të znj. L.Gj., në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Këshilli Bashkiak Berat e ka ekspozuar ankuesen, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues. Në lidhje me qëndrimin e Kryetarit të Bashkisë Berat, Komisioneri gjykon se në rastin konkret ai ndodhet në pozicionin e zbatuesit të aktit administrativ të Këshillit

Bashkiak dhe në këto kushte nuk çmohet se ai e ka pozicionuar padrejtësisht dhe në mënyrë të disfavorshme ankuesen.

B/1 Shkaku i mbrojtur “bindja politike”.

Ankuesja L.Gj. pretendon diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”⁷, nga ana e Z. E.C., Kryetar i Këshillit Bashkiak Berat dhe Z. E.D., Kryetar i Bashkisë Berat.

“*Bindja politike*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “*bindja politike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë.

B/2 Shkaku i mbrojtur “raca”.

Ankuesja L.Gj. pretendon diskriminim për shkak të “*racës*”⁸, nga ana e Z. E.C., Kryetar i Këshillit Bashkiak Berat dhe Z. E.D., Kryetar i Bashkisë Berat.

“*Raca*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, *bindjet politike*, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*racës*”, Komisioneri gjykon se “*raca*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë.

⁷ Referuar kartës së anëtarësisë nr. 4627, datë 12.04.2016, të lëshuar nga subjekti politik “*Lëvizja Socialiste për Integrim*”, rezulton se ankuesja është anëtare e kësaj force politike.

⁸ Referuar vërtetimit nr. 010/20, datë 11.02.2020, të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i shoqatës Roma Versitas Albania, nëpërmjet së cilit vërtetohet se ankuesja L.Gj. i përket komunitetit egjiptian.

B/1 Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – bindja politike.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se znj. L.Gj. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Këshillit Bashkiak Berat.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Referuar nenit 49, të Kushtetutës së Republikës parashikohet: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Në këtë sens, kjo dispozitë i garanton çdo individ të drejtën për punë. Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: *“...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”*.

Referuar vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë⁹, për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012), duke u mbështetur në parimin e tij të nenit 11, të KEDNJ-së, që partitë politike janë thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, Gjykata konsideron: *“Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventave, Gjykata konsideron se në mungesë të masave mbrojtëse gjyqësore një sistem juridik i cili lejon largimin nga puna vetëm për shkak të anëtarësimit të punonjësve në një parti politike mbart me vete mundësinë e abuzimit”* (paragrafi 55).

Në nenin 9, të Kodit të Punës parashikohet shprehimisht: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.”* Parashikimi i mësipërm është hartuar në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe

⁹ Redfearn v The United Kingdom: ECHR 6 Nov 2012

përcakton shkaqet, në bazë të së cilave ndaj një individi mund të ketë diskriminim. Nëpërmjet parashikimit të nenit 12, të ligjit të sipërpërmendur ndalohej diskriminimi, në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji. Neni 12, pika 1, gërma c) i këtij ligji parashikon shprehimisht: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: *““Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *“a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.*

Në nenin 12, pika 1, gërma (c), të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Kodi i Procedurës Administrative¹⁰, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Këshillit Bashkiak Berat, i cili duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS¹¹ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹²

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të ankueses, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri gjykon se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm të ankueses nga ana e Këshillit Bashkiak Berat.

Përsa i përket bindjeve politike të znj. L.Gj., mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përkatësisht në referencë të kartës së anëtarësisë nr. 4627, datë 12.04.2016, të lëshuar nga subjekti politik *“Lëvizja Socialiste për Integrim”*, rezulton që është anëtare e subjektit politik *“Lëvizja Socialiste për Integrim”*.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Berat u zgjodh z. E. D, mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë. Në vijim të konstituimit të Këshillit të ri

¹⁰ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

¹¹ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Bashkiak dhe zgjedhjes së kryetarit të ri të këtij Këshilli, znj. L.Gj. është shkarkuar në mënyrë të menjëherëshme nga detyra e Sekretares së Këshillit Bashkiak, pa asnjë lloj motivacioni, nëpërmjet Vendimit nr. 8, datë 05.08.2019, të Këshillit Bashkiak. Në vijim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Berat ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me ankuesen nëpërmjet urdhërit nr. 589, date 09.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë, “Për përfundimin e marrëdhënieve financiare të Sekretarit të Këshillit të Bashkisë znj. L. Gj.i”. Pas këtyre veprimeve të subjekteve të sipërpërmendura, ankuesja ka ngritur pretendimin se largimi i saj nga pozicioni i punës që mbante është bërë për shkak të bindjes politike.

Referuar Protokollit të mbledhjes së datës 05.08.2019, rezulton se këshilltarët e Partisë Socialiste të Këshillit Bashkiak Berat kanë propozuar znj. B. A. në pozicionin e punës së znj. L.Gj.. Referuar CV se znj. B.A., të publikuar në faqen zyrtare të KQZ rezulton se ajo është aktiviste e Partisë Socialiste, si dhe është propozuar nga kjo forcë politike, për anëtare të Këshillit Bashkiak Berat në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019. Njëkohësisht, referuar të njëjtit dokument ajo është edhe sekretare organizative e FRESSH Berat.

Në rastin konkret, Këshilli Bashkiak Berat në asnjë moment nuk justifikoi dhe motivoi largimin nga puna të ankueses dhe zëvendësimin e saj nga një punonjëse që i përket subjektit politik PS. Komisioneri gjykon se veprimet e ndërmarra nga këto dy subjekte kanë reflektuar faktin se pozicioni i Sekretarit të Këshillit Bashkiak Berat është konsideruar si post politik, edhe pse në asnjë akt ligjor dhe nënligjor nuk është përcaktuar si i tillë.

Në këtë kontekst vlen të theksohet fakti se në Vendimin nr. 00-2014-854 (51), datë 28.01.2014, e Gjykatës së Lartë, është përcaktuar shprehimisht se funksioni i Sekretarit të Këshillit të Njesisë vendore nuk është funksion politik.

Në këto kushte rezulton se është shkarkuar nga detyra pa asnjë motivacion një punonjëse, e cila i përket forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim dhe në vend të saj është emëruar një anëtare e subjektit politik në pushtet.

Në analizë fakteve të mësipërme, Komisioneri gjykon se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga subjektet përkatëse kundrejt ankueses dhe si pasojë barra e provës bie tek këta subjekte.

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Këshilli Bashkiak Berat, në cilësinë e organit kolegjal që shkarkoi ankuesen, duhet të përmbushte dy kushtet e përmendura më sipër. Komisioneri vlerëson se nga ana e këtij subjekti nuk u arrit të provohej që vërtetoheshin dy momentet e mëposhtëme:

1. Nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesja, që janë bindjet e saj politike dhe trajtimin të padrejtë e disfavorshëm nga ana e Këshillit Bashkiak Berat dhe Kryetarit të Bashkisë Berat, të konstatuara edhe nga Komisioneri në këtë vendim ose,
2. Për veprimet e këtyre dy subjekteve kundrejt ankueses kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se znj. L.Gj. është diskriminuar për shkak të bindjes politike nga ana e Këshillit Bashkiak Berat.

B/2 Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – raca.

Gjatë analizimit të fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se ankuesja është ekspozuar para nja trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga Këshilli Bashkiak Berat. Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar nga KMD, znj. L.Gj. shtoi edhe pretendimin e saj, se largimi i saj nga puna mund të jetë kryer, pasi ajo i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Beratit, fakt të cilin ajo e vërtetoi me dokumente zyrtare.

Në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: “...*Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale*”.

Direktiva 2000/43 / EC e Këshillit të Bashkimit Evropian zbaton parimin e trajtimit të barabartë midis personave pa marrë parasysh origjinën racore ose etnike dhe kërkon si domosdoshmëri vendosjen e barazisë racore dhe ndalimin e diskriminimit për shkak të saj. Në kuadër të çështjes në shqyrtim, kjo Direktive mbështetet edhe nga Direktiva 2000/78 / EC e Këshillit të Bashkimit Evropian, e cila krijon një kornizë të përgjithshme për vendosjen e një trajtimi të barabartë në punësim dhe profesion.

Gjithashtu edhe në Rekomandimin 14, datë 22.06.2012, të ECRI¹³-t “*Mbi luftën kundër racizmit dhe diskriminimit në fushën e punësimit*” shteteve palë u rekomandohet shprehimisht: “*Të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për të eliminuar racizmin de jure dhe de-fakto, diskriminimin racor dhe ngacmimin racor për shkak të racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, kombësisë, ose origjinës kombëtare ose etnike (këtu e tutje: racizmi, diskriminimi racial dhe ngacmimi racor) në punësim si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe të adoptojnë ligjin kombëtar dhe mekanizmat e zbatimit që sigurojnë zbatimin aktiv të të drejtave dhe barazisë e plotë në praktikë.*”

Neni 18, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: “*Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.*”

Në Planin Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020), miratuar me Vendimin nr. 1072, datë 23.12.2015, e Këshillit të Ministrave, në Fushën e Politikës “Punësimi dhe Arsimi Profesional” parashikon integrimin e tyre në shoqëri, sidomos nëpërmjet nxitjes së punësimit të tyre dhe qasjen e tyre në këtë fushë. Mbrojtja në fushën e punësimit të anëtarëve të

¹³ Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës, i Këshillit të Europës;

komunitetit rom dhe egjiptian konsiderohet me prioritet nga qeveria shqiptare dhe masat e ndërmarrja për këtë kategori individësh bëjnë pjesë në masat pozitive që ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon për zbatim ndaj kategorive vulnerabël, pasi mundësia e tyre për të gjetur dhe mbajtur një punësim të caktuar, është më e vështirë sesa për të tjerët, pikërisht për shkak të përkatësisë së tyre në këto komunitete.

Në nenin 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ndalohet diskriminimi, në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji. Neni 12, pika 1 , gërma c) i këtij ligji parashikon shprehimisht: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Sikurse u arsyetua edhe në rubrikën e mësipërme, Kodi i Procedurës Administrative¹⁴, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Këshillit Bashkiak Berat, i cili duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Gjatë analizimit të fakteve dhe provave të administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, Komisioneri ka konstatuar se ankuesja është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Këshillit Bashkiak Berat.

Referuar vërtetimit nr. 010/20, datë 11.02.2020, të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Roma Versitas Albania, vërtetohet se ankuesja L.Gj. i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Beratit.

Në vijim të seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së, Këshilli Bashkiak nuk depozitoi prapësimet e tij, në lidhje me këtë pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të racës, pavarësisht detyrimit ligjor, që kishin për të prapësuar pretendimet e ankueses.

Komisioneri gjykon se, pavarësisht sa më sipër, në bazë të provave të administruara nga të dyja palët, nuk rezulton të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakimit të ankueses me përkatësinë e saj në komunitetin egjiptian.

Për sa më sipër, nga analizimi i të gjitha fakteve dhe provave të administruara gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri gjykon se trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankueses nuk ka ardhur për shkak të përkatësisë në komunitetin egjiptian.

¹⁴ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I

- 1.** Konstatimin e diskriminimit të znj. L.Gj., për shkak të bindjes politike, nga Këshilli Bashkiak Berat.
- 2.** Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. L.Gj., për shkak të racës, nga Këshilli Bashkiak Berat.
- 3.** Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – punesim
Shkak – bindja politike, raca